

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



ETIKA

PPROGRAM
MËSIMOR

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin e punës së organeve të udhëheqjes shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02 dhe 82/08) dhe neni 25 paragrafi 2 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/08) ministri i Arsimit dhe Shkencës e ka caktuar programin mësimor të etikës për klasën e VI në arsimin fillor tetëvjeçar

1. HYRJE

Lënda mësimore etika është lëndë e detyrueshme për nxënësit e klasës së VI. Fondi i orëve për lëndën sillet 1 orë në javë, gjegjësisht 36 orë gjatë vitit shkollor.

Me mësimin e kësaj lënde nxënësit do të njihen me rëndësinë dhe kuptimin e etikës dhe moralit në jetën e njeriut, vlerat universale etike si dhe mënyrat e zbulimit dhe respektimi i raporteve humane ndërmjet njerëzve.

Përmes mësimin në lëndën e etikës nxënësit do t'i zhvillojnë shkathtësitë e tolerancës, dialogut respektin dhe bashkëpunimin me tjerët.

2. QËLLIME PËR PERIUDHAT E ZHVILLIMIT NGA KLASA VII DERI IX

Nxënësi/nxënësja:

- të njihet me rëndësinë dhe kuptimin e etikës dhe moralit në jetën e njeriut;
- t'i zbulojë dhe t'i respektojë marrëdhëniet etike ndërmjet njerëzve;
- të njihet me vlerat etike universale;
- të njihet dhe ta pranojë bontonin në shoqërinë bashkëkohore;
- të zhvillojë shkathtësi për tolerancë, dialog, respekt dhe bashkëpunim me tjerët

4. QËLLIMET KONKRETE

TEMA I: ETIKA DHE MORALI (12 orë)			
Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njihet me rëndësinë e lëndës mësimore етика; - të nxitet në mënyrë etike të mendimit. 	<p>Nacionet për etikën</p>	<p>Etika Zgjedhja etike Arsimi etik Mënyra etike e mendimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Biseda për çështje nga lëmi i etikës (me përdorimin e teksteve, shembujve, proverbave). - Diskutim për atë se si mund të zbatohet rëndësia e etikës në jetën e përditshme (të menduarit, zgjidhja e problemit, sjellja etj).
<ul style="list-style-type: none"> - Të njihet me rëndësinë e termeve moral dhe sjellja e moralshme; - ta mbikëqyr rëndësinë e moralit në jetë dhe sjellja e secilit njeri; - të njihet me porositë themelore etike të Shën Klimenti i Ohrit, etiku i parë dhe i fundit maqedonas. 	<p>Morali Rëndësia e moralit Shën Klimenti i Ohrit</p>	<p>Morali Sjellja e moralshme Roli i moralit në jetë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes shembujve adekuat zbulohet rëndësia e nocioneve moral dhe sjellje morale. Luajtja në role dhe dramatizimet për situata të ndryshme nga jeta e njerëzve ku parashtrahet pyetja për sjelljen e moralshme dhe diskutimin për zgjedhjen që e ka bërë individi/grupi në situata të dhëna. Leximi dhe biseda për porositë etike të Shën Klimentit. - Hulumtim: Personaliteti dhe mësimi etik i Shën Klimentit të Ohrit.

TEMA II: VLERA UNIVERSALE ETIKE (12 ORË)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përvetësoj njohuri për vlerat themelore etike të kulturave të ndryshme, popujve, epokave; - ta njeh dhe pranojë sinqeritetin si bazë themelore e njeriut; - ta njeh dhe pranojë të vërtetën si bazë e njeriut; - të nxitet ta flet të vërtetën. - ta njeh dhe ta pranojë drejtësinë si bazë e vlerave të njeriut; - të nxitet të ndërmerret për të drejtën në sjelljen me njerëzit tjerë në jetë dhe në punë. 	<p>Etika në tërë botën</p> <p>Sinqeriteti</p> <p>E vërteta</p> <p>Drejtësia</p>	<p>Vlerat universale etike</p> <p>Sinqeriteti</p> <p>E vërteta</p> <p>Gënjeshtria</p> <p>Rregulla</p> <p>Ligjet</p> <p>Përgjegjësia</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të shikuarit e vlerave etike të kulturave, vendeve, popujve (përmes shembujve, proverbave, mendimeve etike etj). - Biseda për atë se çka është sinqeriteti e çka nuk është mbi bazën e përvojës së nxënësve. - Analiza e dallimeve ndërmjet privilegjeve dhe përgjegjësive/detyrimeve. - Shembuj për përgjegjësitë dhe detyrimet në shkollë dhe familje. - Bisedë për rëndësinë e të vërtetës dhe mirëqenies në jetën e përditshme. - Sqarimi i formave të shpeshta për shkatërrimin e të vërtetës: gënjeshtria, dëshmia e rrejshme. përgojimi, etj. - Hulumtimi: Vallë drejtësia praktikohet në jetën shkollore (familje, mjedis)? - Diskutimi se si zbatohet drejtësia (me rregulla, ligje) në shkollë, shoqëri, në përditshmëri.

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>- Të njihet me tendencat për krijimin e etikës universale të njerëzimit, me vlerat e të gjitha epokave, popujve dhe personaliteteve;</p> <p>- Ti kuptojë vlerat themelore të etikës universale – paqë, mirëkuptim, tolerancë, solidaritet dhe bashkëpunim;</p> <p>- Të zhvillojë ndjenjën patriotike si dashurinë ndaj atdheut, respektimin e normave shoqërore dhe procedurat shtetërore.</p>	<p>Etika universale</p>	<p>Etika e posaçme për njerëzimin në përgjithësi Paqë Mirëkuptim Tolerancë Solidaritet Bashkëpunim</p> <p>Patriotizëm</p>	<p>- Diskutim për vlerat elementare të sotme për tërë botën.</p> <p>- Shembuj nga letërsia, filmi, nga përvoja personale për rëndësinë e vlerave: paqë, mirëkuptim, tolerance, solidaritet dhe bashkëpunim.</p> <p>- Diskutim për rëndësinë e patriotizmit për zhvillimin e shtetit.</p> <p>- Shembuj për respektimin e normave dhe dispozitave shoqërore.</p>
<p>- Të njihet me vlerat etike sa i përket shëndetësisë, mbrojtjes së ambientit dhe mjetet bashkëkohore për punë dhe komunikim.</p>	<p>Etika e shëndetësisë, ekologjisë dhe informatikës</p>	<p>Shëndeti – qëllimi kryesor etik dhe jetësor Mjedisi jetësor Punë me kompjuter</p>	<p>- Diskutimi për normat etike për ruajtjen e shëndetit.</p> <p>- Diskutim për normat etike në ekologji.</p> <p>- Diskutim për normat etike gjatë punën me kompjuter.</p>

TEMA III: SJELLJA E MIRË (12 orë)

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njihet me rregullat e sjelljes së mire ndaj të tjerëve dhe në shoqëri; - Ta dijë kuptimin dhe funksionin e bontonit si sjellje e mësuar mirë dhe sipas rregullave; - Ti njohë rregullat e sjelljes së mire në familje; - Ti njohë rregullat e sjelljes së mire dhe të merr pjesë në sjelljen e tyre; - Ti njohë rregullat e sjelljes së mire ndaj njerëzve tjerë: respektim, mos fyerje, ndihmë etj; - Ti njohë rregullat e sjelljes së mire në opinion (në rrugë, në park dhe sipërfaqe të lira, në institucione publike, në institucione kulturore 	<p>Sjellja e mirë</p> <p>Sjellja në familje</p> <p>Sjellja në shkollë</p> <p>Sjellja ndaj shokëve</p> <p>Sjellja e mirë në opinion</p> <p>Sjellja e mirë ndaj njerëzve tjerë</p>	<p>Sjellja e mirë Mirësjellje</p> <p>Rregullat e sjelljes ndërmjet anëtarëve të familjes; Sjellja e mire në familje;</p> <p>Rregullat e sjelljes ndërmjet shokëve; Sjellja e mire në shkollë</p> <p>Rregullat e sjelljes në shkollë Sjellja e mirë ndaj shokëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bisedë rreth normave të sjelljes së mirë që i njohin dhe praktikojnë nxënësit; - Vallë ka norma të cilat i njohin por nuk i zbatojnë (dhe pse)? - Paraqitja e sjelljes së mirë në familje- respekti ndaj të moshuarve, respekt i ndërsjellë, ndihmë rreth punëve të shtëpisë, mirëkuptim etj. - Vallë ka norma të cilat prindërit i kërkojnë, dhe të njëjtat nuk i zbatojnë (dhe pse)? - Vallë nga mirësjellja reciproke e anëtarëve në familje varet jeta e mirë në të? - Bisedë për sjelljen e mirë në shkollë. - Bërja e listës me rregulla nga nxënësit të cilët do ti respektojnë në sjelljet në klasën e tyre dhe me nxënësit tjerë. - Zhvillimi i bisedës për parimet sipas të cilave udhëhiqen sjelljet me shokët.

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>- Ti njohë rregullat e sjelljes së mire ndaj njerëzve të tjerë: respekt, mosfyerje, ndihmë etj.</p>		<p>Rregullat e sjelljes në opinion Sjellja e mirë në opinion</p> <p>Rregullat e sjelljes ndërmjet njerëzve - parimet e përgjithshme të bontonit Respekt Mosfyerje Ndhimë Mirësjellje</p>	<p>- Vallë mund të ketë sjellje/raporte të mira ndërmjet shokëve nëse nuk mundohen të silen mirë?</p> <p>- Bisedë për rregullat të cilat secili duhet ti praktikojë në sjelljen e vet në opinion.</p> <p>- Vallë duhet pasur kujdes se si sillemi në opinion?</p> <p>- Bisedë për parimet kryesore të respektimit, ndihmës, mosfyerjes etj.</p>

4. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

- Kahe për lidhje me lëndët tjera (planifikim i integruar, përkatësisht lidhshmëri të plotë dhe përmbajtësore ndërmjet lëndëve dhe lëmive të ngjashme).

Në planifikimin e mësimit theksohet lidhshmëria e mësimit me përvojën e nxënësve, si dhe lidhshmërinë ndërlëndore sa i përket qëllimeve dhe përmbajtjeve. Në këtë mënyrë arrihet komplementimi më i mirë me lëndët tjera dhe kooperim në procesin mësimor dhe mësimin.

- Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve (planifikimi i orientuar i orëve mësimore sipas temave dhe tërësive mësimore)

- Fondi vjetor i orëve sipas temave dhe tërësive është dhënë në mënyrë të orientuar, së bashku me qëllimet, temat/përmbajtjet konkrete për të mos kufizuar rishpërndarjen e tyre sipas nevojave gjatë r alizimit.

- Shfrytëzimin më ndryshe të orëve duhet ta vlerësojë mësimdhënësi lëndor sipas të arriturave të nxënësve të tyre, dmth., sipas ndryshimeve në cilësinë e njohurive dhe aftësive të cilat i arrijnë.

Mjetet mësimore:

- libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën përkatëse, i lejuar nga ministri;

- burime tjera të mësimit nga mjedisi i drejtpërdrejtë – dukuritë në shoqëri dhe sjelljet ndërmjet njerëzve;

- vizitë institucioneve dhe njohja me mënyrën e funksionimit të tyre;

- fjalor etik, tekste etike, revista, publikime të posaçme etj;

- Internet, softuerë të popullarizuara ilustrative arsimore;

- mjete audio-vizuale dhe mjete tjera adekuate për lëndën;

5. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Ndjekja e të arriturave të nxënësve

Gjatë mësimit të rregullt ndiqen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, përmbledhen treguesit për aktivitetin e tyre, për motivimin për mësimit, për bashkëpunimin me nxënësit tjerë etj. (vlerësimi formativ).

Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimdhënësit për mësimin dhe të mësuarit.

Në program theksohen mënyrat e përcjelljes, kontrollimit dhe vlerësimit të arriturave të nxënësve në kuadër të temave mësimore.

Mënyra e kontrollimit dhe vlerësimit:

- Gojarisht,
- Prezantimi.

Mjetet tjera dhe procedurat e përcjelljes dhe vlerësimit:

• Ushtrime gojore; bisedë /dialog mësimdhënës-nxënës, si dhe anasjelltas.

Gjatë vitit shkollor nga notat e formuara me shkrim, të formuluara për secilin nxënës në veçanti, si dhe të udhëhequra nga nivelet e parashtruara të arriturave gjatë periudhave të caktuara kohore, mësimdhënësi futë edhe nota përkatëse numerike

6. KUSHTET HAPSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi mësimor i etikës realizohet në hapësirë dhe me pajisje sipas normativit për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor.

7. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Mësimin e lëndës mësimore etikë e realizon mësimdhënësi që ka të kryer Fakultetin e Filozofisë, me titull Profesor i diplomuar i filozofisë.

Programin mësimor për *etikë* për klasën e VII në arsimin fillor tetëvjeçar, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit, e caktoi më ministri i Arsimit dhe shkencës me vendim nr. 01-47/4 nga 22.01.2010.